

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA GLOGOC

GLOGOC MUNICIPALITY

Pranverat

16.06.2023

Komuna / Opština:	Drenas	Data / Datum:	16.06.2023	Nj. Org.	Numër	Shtoja	Vlera
				01	0606812930\$		

Numri i takimit përkthetë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 3

Takim i rregullt / Redovni sastanak

Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

Numri i anëtarëve të KKSBS-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 17

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBS-së?

Da li su predstavnici neveçinskej zajednice, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju neveçinske zajednice

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përvèç anëtarëve të KKSBS-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovaao sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkyetari?

Da li je sastankom predsedavaao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da

Jo / Ne

Nga Stacioni Policor, zyrtari policor Florim Geci

**Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:**

Në mbledhje u diskutuan këto pikat të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 23.03.2023:  
<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/04/Procesverbal-i-takimit-te-kksb-se.pdf>
2. Raport për adresimin e kërkesave të komunës në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore në Prishtinë lidhur me sanimin e gropave nëpër rrugë regionale.
3. Dukuritë negative të adoleshentët dhe veprimet në parandalimin e tyre.
4. Të ndryshme

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

**Konkluzionet / Zaključci:**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) ka mbajtur mbledhjen e radhës me 18 Maj në sallën e Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 17 anëtarë të KKSBB-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit, drejtorë të drejtoreve komunale dhe monitorues nga UNMIK dhe KFOR. Mbledhja u udhwheq nga zyrtari policor z.Flорim Geci.

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan ishin:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 23.03.2023:

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/04/Procesverbal-i-takimit-te-kksb-se.pdf>

2. Raport për adresimin e kërkesave të komunës në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore në Prishtinë lidhur me sanimin e gropave nëpër rrugë regionale.
3. Dukuritë negative të adoleshentët dhe veprimet në parandalimin e tyre.
4. Të ndryshme

Procesverbal i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur më 23.03.2023 u miratua unanimisht, pa ndonjë koment nga anëtarët e KKSBB-së.

Për pikën e dytë, Raport për adresimin e kërkesave të komunës në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore në Prishtinë lidhur me sanimin e gropave nëpër rrugë regionale.

Lidhur me këtë pikë, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Nexhmedin Gruda, njoftoi anëtarët se se paku pesë herë deri tani kanë adresuar email në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore për sanimin e gropave nëpër rrugët regionale të cilat sigurisht që paraqesin rrezik për sigurinë rrugore.

“Duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe kompetencave tona se paku 5 herë se paku deri tash përmes emailit ju kemi drejtu në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore të bëjë sanimin e të gjitha gropave në rrugët regionale, përkatësisht rrugën Drenas Skenderaj, Drenas Komoran Carraleve. Vetëm për rrugën Drenas-Skenderaj i kanë mbyll disa gropë, ndërsa për rrugën tjeter jena në fazën përfundimtare të prokurimit për nënshkrim të kontratës. Para disa ditësh kane qenë i kanë fotografu i kane evitu edhe na të njëjtë i kemi përcjell, dhe jemi duke pritur pasi kanë thënë që shumë shpejtë do të përgjigjen”, wshtw shprehur z.Gruda.

Edhe, zyrtari policor Florim Geci theksoi se si stacion policor kanë marr ankesa të qytetarëve për gropat nëpër rrugë, të cilat i kanë adresuar në komunë, dhe komuna në Ministri pasi për rrugë regionale ata janë përgjegjës.

Anëtarët e KKSBB-së ngritën shqetësimë lidhur me gropat dhe dëmtime që po bëhen nëpër rrugë nga OET-të dhe kërkuan që të evitohen këto probleme të cilat janë rrezik për sigurinë e qytetarëve në komunikacion. Ndërsa tjetërash u përmenden probleme në rrugën Komoran, të lagjja te Mulakt, përkatesisht gropat në hyrje dhe dalje të rrugës, të cilat kërkuan të sanohen.

Drejtori Gruda theksoi se zyrtarët vazhdimisht janë në terren, kanë bërë raport lidhur me gropat e evidentura dhe i kanë përcjell në Ministri. Ndërsa, për ato të cilat eshtë përgjegjëse komuna, njoftoi se aktualisht eshtë kontrata për rehabilitim të rrugëve e cila ka buxhet të kufizuar dhe nuk mbulon të gjitha kërkeshat dhe tjetra kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve eshtë në proces të nënshkrimit pasi ka skaduar ajo e mëparshme.

## 2. Dukuritë negative të adoleshentët dhe veprimet në parandalimin e tyre.

Zyrtarja Policore, Qerime Sallahu, njoftoi për statistikat mbi rastet të dukurive negative tek adoleshentët dhe bashkëpunimin me DKA-në. Ajo theksoi se krahasim me vitin e kaluar, ka trend të rritjes, ku vetëm në 5 majorin e vitit 2023 janë 9 raste si për: armëmbajtje pa leje, lëndime të lehta trupore, etj. Ka edhe raste që mbesin shënim zyrtar brenda stacionit dhe që trajtohen nga Qendra për Punë Sociale. Zyrtarja policore njoftoi se eshtë rritur numri i zyrtarëve policor që përkujdesen për sigurinë në shkolla nga 2 në 4 me rroba civile si dhe patrulla policore nëpër fshatra që raportojnë në baza të vazhdueshme.

Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Muhamet Gjoka theksoi se kanë rritur numrin e psikologëve, përkatesisht katër psikologë në shkolla që kanë numër më të madh të nxënësve. Drejtori Gjoka u shpreh se janë në kontakt të vazhdueshëm me polisinë, këshillin e prindërve dhe gjithë akterë tjerë të përfshirë në këtë zingjir të kontrollit dhe parandalimit të rasteve që cenojnë sigurinë e nxënësve.

Drejtori i Hendikos-it, Behxhet Binaku, para anëtarëve u shpreh se krijimi i një task-force i përbërë me të gjithë anëtarët e sektorëve përgjegjës për sigurinë në shkolla, të cilët do të analizonin çdo rast dhe faktorë që vijnë deri te këto raste.

Arben Haziri nga Këshilli i Prindërve theksoi se bashkëpunimi i prindërve me shkolla eshtë i ulët sepse vetëm në raste ekstreme interesohen për problemet e fëmijëve.

## 3. Të ndryshme

z. Skender Bogiqi nga KLSP shprehu nevojën për një zyre, përkatësish shfrytëzimin e ndonjë hapësirë të mundshme në objektin e Gjendjes Civile në Komoran.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSBS-së  
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laurëta Thaqi  
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i përdorur)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Berniz Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravania: 16.06.2023

**Rekomandimet:**

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSBS-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: [mpb.ds@rks-gov.net](mailto:mpb.ds@rks-gov.net)
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: [Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net](mailto:Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net)

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSBS-së.